



Datë: 13.10.2025
Numër Protokolli: 6820/2025

A.nr.1659/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1659/2025, të datës 03.09.2025, të parashtruar nga ankuesi N.R, kundër organit të punësimit: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1659/2025, e datës 03.09.2025, e parashtruar nga ankuesi N.R.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 30.08.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me rezultatin përfundimtar sipas konkursit me Nr. Reference: RN00018234 për pozitën Zyrtar Ekzekutiv i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Leposaviç.

A r s y e t i m

Ankuesi N.R (*më tej referuar vetëm: Ankuesi*), më datë 03.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimi i datës 30.08.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me rezultatin përfundimtar sipas konkursit me Nr. Reference: RN00018234 Zyrtar Ekzekutiv i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Leposaviç.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 16.09.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa, ky i fundit, më datë 22.09.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5916/2025 të datës 04.09.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 30.08.2025 për rezultatin përfundimtar; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.09.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1659/2025 të datës

22.09.2025; Vendimin me numër 01/1082/2-2025; Konkursin me numër reference RN00018234 të datës 15.07.2025 për pozitën e punës Zyrtar Ekzekutiv ne Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në Leposavic; Njoftimin e datës 26.07.2025 për verifikimin paraprak; Listën e kandidateve të aprovuar; Vendimin me numër 02/1-1190-2025 të datës 30.06.2025 për themelimin e komisionit për pranim; Akt emërimet e anëtareve të komisionit për emërim; Diplomën universitare të kandidatit të përzgjedhur me dokumentet e bashkangjitura (Certifikat); Dokumentin e identifikimit të kandidatit të përzgjedhur; Aktin e emërimit NR.31/2011 të datës 15.07.2011 Aktin e emërimit numër 03/2016 të datës 01.12.2016; Aktin e emërimit me numër 03/2017 të datës 01.09.2017; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Formularët e vlerësimit individual të datës 25.08.2025 të anëtareve të komisionit për kandidatin në intervistë; Pyetjet për vlerësimin e intervistës si dhe listën e pjesëmarrësve në intervistë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Sekretariati i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, më datë 15.07.2025, ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00018234, Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita *“Zyrtar Ekzekutiv i Komisionit Komunal te Zgjedhjeve”* në Leposaviq, për realizimin e një projekti me afat të caktuar, një pozitë, me afat aplikimi nga data 15.07.2025 deri me datë 21.07.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se, në këtë konkursi kanë aplikuar 4 (katër) kandidatë prej tyre në fazën e verifikimit paraprak janë përfshirë te gjithë kandidatë mesin e tyre edhe ankuesi. Ndërsa pas përfundimit të procedurës së intervistës Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, më datë 30.08.2025 ka publikuar rezultatin përfundimtar sipas të cilit si kandidati fitues është M.S me 69.33 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kandidati i përzgjedhur nuk ka qëndruar gjatë në testim pasi që i njëjti ka deklaruar se nuk i ka ditur përgjigjen e pyetjeve dhe se kandidati fitues është anëtarë i një partie politike dhe ky pozicion i punës nuk i takon pasi që është apolitik. Ankuesi po ashtu kërkon që të vërtetohet ky dyshim dhe të vendoset në bazë të ligjit.

Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, i'u referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë, kështu që, nisur nga ky referim ligjor rrjedhë së të punësuarit në administratë të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve kanë statusin e nëpunësit civilë me status të veçantë dhe së mbi këtë bazë ligjore Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e rekrutimit të personelit të përkohshëm në këtë institucion, gjegjësisht me Rregulloren (KQZ) NR.02/2024 për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit me numër të referencës RN00018234, ka gjetur së konkursi përkatës është hap mbi bazën e nenit 37 paragrafi 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publik dhe nenit 10 të Rregullores (KQZ) Nr. 02/2024 për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ, ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale në këtë konkurs kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit te larte me se paku tri (3) vite te studimeve. Lloji i arsimimit – i pa specifikuar si dhe Përvoja e punës së kërkuar se paku dy (2) vite përvoja pune.** Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit pas konstaton se konkursi i datës 15.07.2025 për pozitën e punës *“Zyrtar Ekzekutiv”* i komisionit komunal

të Zgjedhjeve është në pajtim me Rregulloren (QRK) 07/2024 përkatësisht me shtojcën I organorgami i sekretariatit të KQZ-së pika 5.b i cili përcakton se pozita “Zyrtar Ekzekutiv” klasifikohet në klasën profesional 1 dhe grupin specialit i administrimit të përgjithshëm.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pretendimeve ankimore të ankuesit se kandidati i përzgjedhur nuk i është përgjigjur pyetjeve është i pa bazuar sepse bazuar ne formularët e vlerësimit te datës 25.08.2025 nga ana e Komisionit Vlerësues Kolegji ka gjetur se kandidati i përzgjedhur është vlerësuar me se shumti pikë, ndërsa pretendimi se i njëjti është anëtar aktiv i një patrikë politike këshilli nuk ka asnjë prove relevante qe e mbështet këtë pretendim. Bazuar ne shkresa te lendes te cilat organi i punësimit ka përcjell me date 22.09.2025 në Këshillin e Pavarur rezulton se ankuesi ka diplomën universitare me numër 1329 te datës 01.11.1999 me te cilin ka marr titullin Inxhinier i Teknologjisë, ndërsa sa i përket përvojës se punës i njëjti përmes Akt emërimit me numër 873-2011 te datës 15.07.2011 deri me datën 22.11.2022 ka qene i punësuar në Komisionin Qendror te Zgjedhjeve me titullin e punës “Zyrtar i Larte Komunal Zgjedhor” , që lë të nënkuptoj se ankuesi plotëson kushtet formale të cilat janë kërkuar në bazë të konkursit me numër reference RN00018234 te datës 15.07.2025 për pozitën e punës “Zyrtar Ekzekutiv”

Kolegji i Këshillit ju referuar Rregullores (KQZ) Nr. 02/2024 Pranimi i Personelit Përkohshëm në KQZ gjegjësisht me nenin 20 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi i kandidatëve për pozitën profesionale për realizimin e projektit të caktuar përbëhet nga intervista dhe vlerësimi i jetëshkrimit dhe zhvillohet nga Komisioni i pranimit me mbështetjen e NjMBNj. 2. NjMBNj njofton kandidatët që kanë kaluar verifikimin paraprak lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 3. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në shpalljen e konkursit. 4. Intervista që zhvillohet është intervistë e strukturuar nga Komisioni i Përzgjedhjes, i cili përgatit grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. 5. Intervista përmban dhjetë (10) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti shtatë (7) pikë. 6. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti njëgind (100) pikë, prej të cilave tridhjetë (30) pikë për jetëshkrimin (CV). 8.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 8.1. Deri në dhjetë (10) pikë për arsimimin; 8.2. deri në pesëmbëdhjetë (15) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 8.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet relevante. 9. Secili nga anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje dhe jetëshkrimin.

Andaj me kuadrin ligjor të cekur si më lartë, Kolegji i Këshillit, vlerëson se anëtarët e Komisionit vlerësues kanë bërë vlerësimin e kandidatëve në intervistë me gojë, kështu që në fazën e intervistës nuk është evidentuar ndonjë shkelje procedurale apo materiale, dhe për rrjedhojë Njoftimi i datës 30.08.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me rezultatin përfundimtar sipas konkursit me Nr. Reference: RN00018234 për pozitën “Zyrtar Ekzekutiv i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve” në rajonin e Leposaviçit për KQZ, është nxjerr në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 të Rregullores (KQZ) Nr. 02/2024 Pranimi i Personelit Përkohshëm në KQZ, ndërsa ankuesi nuk ka arritur që pretendimet e tij ankimore t’i argumentoj me prova konkrete materiale.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA A.nr. 1659/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit N.R;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së